



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 633 Prot

Tiranë, më 19.12.2022

V E N D I M

Nr. 42, datë 19.12.2022

“PËR EMËRIMIN PARAPRAK TË SHITETASË IRIS MEÇANI SI NËPUNËS
CIVIL GJYQËSOR “SEKRETAR GJYQËSOR”

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga:

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

Zëvendëskryetare e Gjykatës

Blerona HASA

Anëtare

Leonard STRATAJ

Anëtar

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Kristina PËRNASKA** i mbledhur në Tiranë sot, në datë **19.12.2022**, pasi kreu procedurën e vlerësimit të aplikueses për plotësimin e vendit vakant në shërbimin civil gjyqësor në këtë Gjykatë, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil të znj. Iris Meçani,

V Ë R E N

Se Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, ka miratuar procedurën për plotësimin e vendeve vakante në shërbimin civil.

Nga ana e Gjykatës është njoftuar Këshilli i Lartë Gjyqësor se pranë këtij institucioni janë 4 (katër) vende vakante në shërbimin civil gjyqësor, kategoria ekzekutive “*Sekretar gjyqësor*”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka njoftuar Gjykatën Administrative të Apelit se Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon për momentin nëpunës civil gjyqësor të regjistruar, sipas pikës 1, të nenit 4, të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 dhe në mungesë të kësaj liste Këshillat duhet të procedojnë me procedurat e rekrutimit sipas parashikimit ligjor dhe nënligjor.

Në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ, parashikohet se vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor plotësohen me rikthimin në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, rikthimin, për shkak të pezullimit, sipas neneve 67 dhe 68 të ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”, nëpërmjet transferimit, sipas nenit 66 të ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”. Në rast të pamundësisë për plotësimin si më sipër, atëherë në radhë zbatohet lëvizja paralele, ngritja në detyrë dhe në fund pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Në këto kushte Këshilli i Gjykatës në mbledhjen e datës 12.10.2022, vendosi të procedojë për plotësimin e vendeve vakante me anë të lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe shpalli njoftimin në faqen zyrtare të KLGJ, Gjykatës, si dhe gjithë gjykatave të vendit me kushtet e kërkuara.

Në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele u paraqitën dy kandidatura nga të cilat vetëm njëra prej tyre është emëruar nëpunës civil gjyqësor “*Sekretar Gjyqësor*” pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Në lidhje me procedurën e pranimin në shërbimin civil gjyqësor është paraqitur aplikimi i shtetases Iris Meçani dhe nga verifikimi paraprak i Kancelarit të Gjykatës, datë 07.11.2022, aplikuesja është kualifikuar për fazën e dytë, atë të vlerësimit.

Po kështu, Këshilli me Vendimin nr. 566, datë 15.11.2022 ka caktuar Komisionin e Pranimin, sipas nenit 54 të ligjit nr.98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin gjyqësor civil” dhe më konkretisht Kancelarin e Gjykatës me cilësinë e kryesuesit, Kryesekretaren znj. Adela Duma si dhe përfaqësuesin e KLGJ znj. Brunilda Kola, caktuar me shkresën nr.5976/1 Prot., datë 18.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar edhe Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurrimit të hapur”, pra përpara vlerësimit, dhe për rrjedhojë Këshilli u bazua edhe mbi këtë vlerësim.

Në datën 25.11.2022, ora 11:00, në mjediset e Gjykatës Administrative të Apelit është zhvilluar vlerësimi i kandidatës nga Komisioni i Pranimin, në përfundim të të cilit ajo ka marrë 49.7 pikë nga 60 pikë që parashikon neni 27 i Vendimit të KLGJ nr. 622, datë


pikë nga intervista. Në total rezulton se aplikuesja Iris Meçani ka marrë 85.699 pikë dhe ajo duhet të shpallet fituese e kësaj procedure konkurrimi e për rrjedhojë të marrë emërimin paraprak, sipas nenit 61 të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 34 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”. Në kushtet kur kandidatja Iris Meçani plotëson kushtet formale për pranim, si dhe ka marrë 85.999 pikë në vlerësim, Këshilli i Gjykatës çmon se ajo duhet të emërohet si sekretare gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, për rrjedhojë:

V E N D O S I

1. Emërimin paraprak të znj. Iris Meçani në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin “Sekretar Gjyqësor” pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Vendimi t’i njoftohet kandidates znj. Iris Meçani dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën kompetente.

Tiranë, sot në datë 19.12.2022.

Anëtar
Leonard STRATAJ



Anëtare
Blerona HASA



Kryetare
Enkelejda METALIAJ
(SOFTA)



Sekretare
Kristina PËRNASKA

